

Abstrakti

“Organizatat Ndërkombëtare - civilizues gjentil i zhvillimit të të drejtave të njeriut në Kosovë” nga

JEHONA KRASNIQI

Objekti dhe Arsyetimi i temës së studimit

Respektimi i lirive, të drejtave të njeriut dhe dinjitetit njerëzor është mision parësor mbi të gjitha misionet njerëzore. Gjë që personalisht mendoj se nuk do duhej ta kishte si mision vetëm juristi, por se cili qytetar i botës. Kjo edhe është arsyeja pse unë kam vazhduar studimet e mija në këtë drejtim dhe pikërisht temën e diplomës në nivelin master e kam zgjedhur pikërisht në këtë fushë.

Kjo më së miri është paraparë në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, të datës 10 Dhjetor të vitit 1948, e nxjerrur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. e cila nga pohimet e parapara në preambulën e saj, ka nxjerrur këtë deklaratë, si më themelorja dhe më e rëndësishmja në historinë e njerëzimit. Në preambulën e saj thuhet:

Meqë njohja e dinjitetit të lindur të të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themel i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë; meqë mosrespektimi dhe përbuzja e të drejtave të njeriut çonte drejt veprimeve barbare, që fyenin ndërgjegjen njerëzore, dhe meqë krijimi i një bote në të cilën njerëzit do të gëzojnë lirinë e fjalës, lirinë e besimit dhe lirinë nga frika dhe skamja është shpallur si aspirata më e lartë e çdo njeriu; meqë është qenësore që të drejtat e njeriut të mbrohen nga sistemi juridik ku do të sundojë ligji, që njeriu të mos shtrëngohet të rebelohet dhe të ngritet kundër tiranisë dhe shtypjes, duke përdorur atë si mjet të fundit; meqë është qenësore që të nxitet zhvillimi i marrëdhënieve miqësore ndërmjet kombeve; meqë popujt e Kombeve të Bashkuara përsëri shpallën në Kartë besimin e tyre në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe në vlerën e personalitetit të njeriut dhe në barazinë midis burrave e grave dhe vendosën të nxisin përparimin shoqëror dhe të përmirësojnë nivelin e jetesës në një liri më të plotë; meqë shtetet anëtare u zotuan që në bashkëpunim me Kombet e

Bashkuara të sigurojnë respektimin e përgjithshëm dhe zbatimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; meqë kuptimi i përbashkët i këtyre të drejtave dhe lirive është më i rëndësishëm për realizimin e plotë të këtij zotimi; ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME e OKB-së shpall këtë DEKLARATË UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT ¹si ideal të përbashkët të cilin duhet ta arrijnë të gjithë popujt dhe të gjitha kombet, në mënyrë që çdo njeri dhe çdo organizëm i shoqërisë, duke pasur parasysh gjithnjë këtë Deklaratë, të synojnë që me anë të arsimit dhe edukimit, t'i kontribuojnë respektimit të këtyre të drejtave dhe lirive dhe që me masa progresive kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurojnë njohjen dhe zbatimin e tyre të përgjithshëm dhe të njëmendtë, si midis popujve të vetë shteteve anëtare, ashtu edhe midis popujve të atyre territoreve që ndodhen nën administrimin e tyre.²

Shprehja "gentle civilizer" nënkupton që një entitet ose forcë që kontribuon në përparimin dhe përmirësimin e shoqërisë në mënyrë të butë dhe paqësore. Në kontekstin e organizatave ndërkombëtare, kjo shprehje nënkupton se këto organizata ndihmojnë në civilizimin dhe thellimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe në përhapjen e vlerave siç janë të drejtat e njeriut dhe paqja. E tëra kjo nërmjet ndikimit të tyre diplomatik, apo siç edhe njihet diplomacia e butë.

Në gjuhën shqipe, "gentle civilizer" mund të përkthehet si "civilizues i butë" ose "civilizues paqësor".

Gjatë përcaktimit të temës së Masterit, kam pasur parasysh se në çka konsiston rëndësia e studimit, njohjes dhe implementimit të lirive dhe të drejtave të njeriut në Kosovë dhe më gjerë, ku edhe qëllimi i kësaj teme është të vihet në pah se "në çfarë raporti është e drejta jonë pozitive me Konventat Ndërkombëtare për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut".

¹ <https://www.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights> eng.
https://www.ohchr.org/sites/default/files/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf alb

² **Universal Declaration of Human Rights**

<https://www.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights>

Perkthimi nga deklarata universale per te drejtat e njeriut, wikipedia 25.08.2024

<https://web.archive.org/web/20180328223249/http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albania/n/Ahri/AUniversalDeclarationHumanRightsfinal.pdf>

Kësisoqi, e kam parë të arsyeshme një studim të hollësishëm dhe specifik të kësaj çështje juridike, duke e ndarë në tre kapituj, si më poshtë:

Në kapitullin e parë, do të bëhet fjalë më shumë për kuptimin dhe zhvillimin e Organizatave Ndërkombëtare të cilat janë një faktor kyç në lindjen, zhvillimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në botë.

Ky kapitull do të përqendrohet në konceptin dhe zhvillimin e organizatave ndërkombëtare. Ku do të diskutohet për rolin e këtyre organizatave në kontekstin global dhe historik, duke theksuar kontributin e tyre në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Po ashtu, do të shtjelloj konceptin e të drejtave të njeriut dhe mënyrën se si këto organizata kanë ndikuar në përmirësimin e tyre.

Në kapitullin e dytë, do flasim për sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në botë sipas Organizatave Ndërkombëtare, respektivisht OKB-së, BE-së dhe sistemit Ndëramerikan për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në këtë kapitull, do të përshkruaj sistemet e ndryshme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut që ekzistojnë në nivel ndërkombëtar, duke përfshirë rolin e OKB-së, BE-së dhe ai ndëramerikan. Po ashtu do diskutohet mbi mekanizmat specifikë që këto organizata kanë zhvilluar për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe ndikimin e tyre në skenën globale.

Në kapitullin e tretë, do të flitet për kornizën ligjore në Kosovë, rreth mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Si dhe ndikimin e të drejtës ndërkombëtare dhe europiane në fushën e të drejtave të njeriut.

Në kapitullin e katërt, te Përfundimet dhe Rekomandimet, do flasim për rolin që kanë pasur dhe që e kanë luajtur Organizatat Ndërkombëtare në Kosovë.

Në kapitullin e pestë, është e përfshirë e tërë literatura e shfrytëzuar përgjatë punës sime.